REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA QYTETIT TIRANE
KOMISIONI KTHIMIT DHE KOMPESIMIT
TE PRONAVE ISH PRONAREVE
RAJONI NR.2
Nr. 567 prot.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
T I R A N E
Nr. 3529 Dt. 16. 10 199
VËRTETOHET FOTOKOPJA E
NJEJTE ME ORIGJINALIN
Tirane, me 16.10.96 NOTERE
LEONORA HALILI
TIRANE ALBANIA
TEL 343 97

V E N D I M

Nr. 567 date 22.05.96

PER

KZHIMIN DHE KOMPESIMIN E PRONAVE

Komisioni kthimit dhe kompesimit te pronave ish pronareve i Bashkise qytetit Tirane sot me dt 22.5.96 mori ne shqyrtim kerkesen e bere nga ish pronari Kisha Katolike "Zemra e Krishtit" urdhri Jezuit me Nr.306 te aktit me objekt kthimin e prones se tij te perbere nga dy parcela trualli me sip. e para 407 m2, e dyta 573 m2 ngjitur njera me tjetren si dhe te tre godinave 1KT ngritur njera mbi trualli e pare e dy te tjerat mbi truallin e dyte. Te gjitha se bashku gjenden ne lagjen e Re te Tiranes ne Jug te rr.Kavajes e Lindje te rr.Spahinjve dhe kufizohen: e para Veri me pronen e vete kishes (Kisha Katolike "Zemra e Krishtit" dhe godina 2 KT e prane saj), JUgu parcela e dyte dhe Lindje pjeserisht me familjen Luarasi e truallin e vete kishes, Perendim rr, Spahinjve. e dyta : Veriu parcela nr. 1 dhe Jugu familja e N.Hoxhes ,Lindje prone e vete pronarit, Perendim rr. Spahinjve.

Pronat figurojne te njohura nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, Nr.343 dt.26.01.1996

K O M I S I O N I

pasi kontrolloi te gjitha dokumentacionin e paraqitur nga ish pronari konstatoi se ai eshte i plote dhe konforme kerkesave te ligj it 7698 dhe akteve nenligjore .Specialistet bene verifikimin ne vend dhe hartuan p-v nga i cili rezultoi se:

1. Parcela e pare ka sip. 407 m2, mbi te eshte akoma sot godina 1KT prone e KishesKatolike "Zemra e Krishtit" me sip.67.5 m2 ( ne genplanin bashkangjitur nr.1 ),godines ekzistuese i jane bere edhe shtesa anesore me sip145.7 m2 ( ne genplanin nr.2). Ne baze te preventivit del se vlera e shtesave anesore eshte 40% te vleres te plote te objektit pra 20% mbi perqindjen e caktuar per te cilen pronari paguan. Vlera e plote 852561 leke. 20 % e 852561% = 170512 leke. Pra sasia e lekeve qe do te paguaje pronari Kisha Katolike"Zemra e Krishtit" eshte 170512 leke.

./.

Kjo shtepi aktualisht eshte ne pronesi te familjes te Abaz Dinaj e cila ka blere nga shteti e rregjistruar ne ipoteke ne nr.42 dt.29.2.1962.

2. Parcela e dyte ka sip. 573 m2 mbi kete truall ekzistojne akoma dy shtepi 1 KT (njera me bodrum) ( ne genplanin Nr.3 e 5 ) ish prone e Kishes Katolike "Zemra e Krishtit" me sip. S3=67 m2,S5=40 m2, godines S3 qe eshte me bodrume dhe godines S5 i jane bere dy shtesa anesore S4+S6=27.5 m2+ 5 m2=32.5 m2. Vlera e shtesave te bera nga shteti nuk i kalon kufirin e 20% te vleres se plote. Ne krye te parceles nga ana perendimore eshte ndertuar dhe nje godine 1KT S7=5.6 m2 pa leje. Keto godina jane akoma dhe sot prone e shtetit te pa pripatizuara ku banojne banor te ndryshem.

Me vendimin e Gjykaes Rrethit Tirane Nr.343 dt.26.01.1996 i eshte njohur sip. 4486 m2. Me vendim Nr.567 dt.22.5.1996 i eshte kthyer kishes sip. prej 2676 m2. Ky vendim do trajtoje sip.980 m2. Pjesa tjeter prej 830 m2

Nebaze te pikes 2/a te VKM nr.301 dt.14.06.1993 : komisioni

V E N D O S I

1. Te njohe Kishes Katolike "Zemra e Krishtit" ish pronare e dy parcelave toke, e para me sip.407 m2 e ndodhur ne lagjen e Re te Tiranes dhe kufizuar:Veri vete pronari(Kisha Katolike),Jugu parcela e dyte e kishes,Lindje familje Luarasi e pjeserisht prone e vete kishes(ish F. Andoni),Perendim rr.Spahinjve si dhe nje godine 1KT ngritur mbi [illegible].

e dyta me sip.573 m2 e ndodhur po ne lagjen e Re te Tiranes e kufizuar:Veri parcela e pare (prone e kishes),Jugu prona e H.Hoxhes,Lindje prone e kishes(ish A.Paskali),Perendim rr.Spahinjve si dhe 2 godinat 1KT (njera me bodrume)mbi kete parcele.

Prona kthehet dhe kompesohet si me poshte:

a- ne baze te nenit 4 te ligjit 7698 dt.15.4.1993 i kthehet pronarit Kisha katolike "Zemra Krishtit" urdhri i Jezuit pronesia mbi trojet me sip.S=407+573=980 m2 (shih genplanin bashkangjitur) si dhe mbi tregodinat e ngritura mbi keto troje me sip. S1=67.5 m2, S3=67 m2, S5=40m2 si dhe shtesa te bera godinave Nr.4dhe Nr.6 ne genplanin bashkangjitur me sip S4=27.5 m2 dhe S6=5 m2.

b- ne baze te nenit 10 e 13 paragrafi 2-te i ligjit 7698 dt.15.4.93 Kishes Katolike"Zemra Krishtit" i jepet pronesia mbi shtesen e godines qe ne genplanin bashkangjitur ka Nr.2 dhe Sip.145 m2 kur Kisha Katolike "Zemra e Krishtit" urdhri i Jezuit te paguaje shumen prej 170512 lekesh.

Mosmarveshja midis paleve mund te zgjidhet me rruge gjyqesore. Perso te trete d.m.th fam. aAbaz Dines (trash e tij) shteti i kthen masen e shperblimit sipas çmimit te shitjes ne kohen e tjetersimit e konvertuar me indeksin e rritjes se çmimeve.

Trojet e lire kufizohen(te dyja bashke):Veriu Kisha Katolike "Zemra e Krishtit" dhe godina 2 Kt ne lindje te kishes prone e vete kishes(me tre ballna 19 m, 17 m, 20 m),Jugu prone e kthyer H.Hoxhes(me ball 43,5m), Lindje prone e kther Kishes Katolike "Zemra e Krishtit" me ball 29 m dhe me truall te lire per kalimin e pall.5 KT me ball 2.5 m,Perendimi me ball 16 m me ish rrugen e Spahinjve sot rr."M.Ulqinaku".

Prona figuron e njohur nepermjet vendimit te Gjykates Rrethit Tirane Nr.343 dt.26. 01.1996

2. Kundra ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

3. Nje kopje e ketij vendimi mund te dergohet per rregjistrim ne Ipoteke dhe ne Kadastren Urbane.

KRYETARI KOMISIONIT:
LULZIM COLLAKU

# PLAN VENDOSJA E PRONES SE KISHES KATOLIK

MARRE NGA PLANSHETA
TR - P - 10 - 9

**ZEMRA E KRISHTIT, URDHER JEZUSIT**

SH. 1:50




PUNOI : G. MARTIN
PUNOI : SH. AHMETAGA
VIZATOI : M. LLAHO KONTROLLOI : ING. H. CAMI
QERSHOR 1996